



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 14 datë 12.3.2021

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKËFINANCIMIT PËR PËRSHTATJEN
PËR STREHIM SOCIAL TË OBJEKTIT TEK KONVIKTI I SHKOLLËS
INDUSTRIALE "ARBEN BROCI,, NË ZBATIM TË PROGRAMEVE TË
STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2021,,**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24 pika 2, neni 29 pika 1, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të nenit 4, pika 1 e nenit 40 të ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", VKM nr.458 datë 03.07.2019 "Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore, që përshtaten nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me grante konkurruese nga buxheti i shtetit", pika 7 e Udhëzimit të Ministrit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, VKB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar të bashkisë Shkodër për vitin 2020-2022", pika 3 e VKB nr. 63 datë 28.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë së Shkodrës", Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 657, datë 14.01.2021 "Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021", dhe relacionit të paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për përshtatjen për strehim social të objektit tek konvikti i shkollës Industriale "Arben Broci".

2. Përqindja e bashkëfinancimit të jetë jo më pak se 20% të vlerës së rikonstruksionit, bazuar në preventivin e punimeve, në një vlerë deri në 12,638,942.1 lekë.
3. Burimi financimit do të jetë nga rialokimi i fondeve gjendje të papërdorura të vitit 2020.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.3.2021